



UNIVERSITETI "KADRI ZEQA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Prof. Dr. Bajram Kosumi
Rektor

Për çdo 17 janar ne kthejmë shikimin dhe vëmendjen kah Kadri Zeqa, Jusuf Gërvalla, Rexhep Mala, Nuhi Berisha e Bardhosh Gërvalla. Para dyzet vjetëve ata e ndezën flakën e revolucionit të Kosovës me gjakun e tyre. Revolucionit i nisur në vitin 1981 po shndërrohej në një proces pa kthim prapa.

Atëherë pak njerëz e kuptonin idealin e Kadriut, Jusufit, Rexhepit e Nuhiut, e aq më pak edhe veprimin e tyre. Ata ranë heroikisht, të bindur se me vdekjet e tyre kjo flakë e lirisë do të ndizej e shndriste më shumë.

Pas rënies së tyre në altarin e lirisë, karvani i nisur me Hasan Prishtinën, Adem Demacin, Metush Krasniqin e shokët e tyre, u bë shumë më i madh ndërsa në historinë shqiptare ky revolucion u bë i pakthyeshem.

E njëjta situatë është përsëritur në marsin e vitit 1998, me Jasharajt: rënia e Jasharajve e vendosi dhe e vulosi fatin e luftës në Kosovë dhe lirinë e Kosovës.

Sot i kujtojmë të gjithë që u flijuan për lirinë e Kosovës, po në veçanti ata që hapën rrugë e shtigje për këtë liri. I kujtojmë duke menduar dhe diskutuar për idetë e tyre, për filozofinë e tyre, për politikën e tyre dhe në fund edhe për rënien e tyre.

Ata nuk e kanë pasur lehtë. Ata e kanë bërë të pamundurën. Atëherë kur askush nuk e shihte dritën- ata na drejtonin kah drita.

Atëherë kur askush nuk besonte te liria- ata vdisnin për lirinë.

Atëherë kur askush nuk shpresonte te fitorja- ata vdisnin duke kënduar këngë fitoreje.

Sot i kujtojmë për të dëshmuar se çdo vit që kalon, kujtimi dhe besimi te ideali dhe vepra e tyre kthjellohet më shumë.

Sot, ne kemi fatin, si brez, që kemi midis nesh njerëz që vepruan bashkë me etërit e lirisë, apo qenë pjesë e atyre proceseve. Kam kënaqësinë e vecantë që sot me ne janë dy miq të mi, që të dy pjesë e rëndësishme e proceseve për të cilat po flasim.

Hydajet Hyseni, të cilin e njihni të gjithë, sot deputet i Kuvendit të Republikës, e i cili do ta mbajë ligjëratën e parë me këtë temë, ka qenë njëri prej atyre prijatarëve.

Myrvete Dreshaj Baliu, profesoreshë në Universitetin e Prishtinës, e cila do ta ketë ligjëratën e dytë, po ashtu ka qenë pjesë e atij procesi, vuajti dënime të gjata burgu për veprimtarinë e saj çlirimtare dhe pati një rol të madh në pajtimin e gjaqeve.

Ligjëratat e tyre në Universitetin Publik Kadri Zeka, në rrugën që mban emrin e heroit tonë Zija Shemsiu, para stafit akademik, studentëve dhe qytetarëve tjerë të ftuar, është dëshmi se idealet e Revolucionit të vitit 1981 në një shkallë të parë janë realizuar dhe Kosova është në rrugën e saj të drejtë kah përparimi.

Gjilan, më 17.01.2022